

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6936
E mërkurë, 5 korrik 2023
Çmimi 0.40

Hapet edicioni i 22-të i Universitetit Veror të Prishtinës



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KRYEMINISTRI I HOLANDËS DHE AI I LUKSEMBURGUT VIZITOJNË KOSOVËN

HOLANDA DHE LUKSEMBURGU: TË PËRMBUSHEN KËRKESAT E BE-së PËR SHTENSIONIMIN E SITUATËS NË VERI



Kryeministri i Holandës, Mark Rutte, dhe ai i Luksemburgut, Xavier Bettel, kanë kërkuar nga Kosova t'i përmbushë tri kushtet e BE-së për shtensionimin e situatës në veri të Kosovës. Në një konferencë të përbashkët

për medie me kryeministrin Albin Kurti në Prishtinë, ata kanë thënë se shtensionimi i situatës në veri është në interes të paqes dhe stabilitetit rajonal. Ata kanë kërkuar nga Kosova dhe Serbia që t'i kthehen

dialogut. Ndërsa kryeministri Kurti ka thënë se Kosova dëshiron raporte të mira fqinjësore me Serbinë, por ka kërkuar të zbatohet marrëveshja drejt normalizimit, të cilën e kanë nënshkruar gjatë këtij viti

CLINTONI JEP MESAZH NË TIRANË: DUHET T'I NDALIM MARRËZITË NË VERI TË KOSOVËS



SHBA-ja SHËNON 247-VJETORIN E PAVARËSISË, KOSOVA E URON DHE E FALËNDERON PËR PËRKRAHJE



KURTI: KOSOVA, NJË ZGJIDHJE IDEALE PËR INVESTITORËT

AUDITORJA E PËRGJITHSHME:
S'KA AUDITIM NË KATËR KOMUNAT
VERIORE

SPORT



CANA: NË ROMË ENDE MA KUJTOJNË
KUPËN E ITALISË

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fac: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@t.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Stoltenbergut i zgjatet mandati në krye të NATO-s

BRUKSEL, 4 KORRIK - Ambasadorët e 31 shteteve anëtare të NATO-s kanë vendosur që t'ia vazhdojnë edhe për një vit mandatin sekretarit të përgjithshëm të aleancës, Jens Stoltenberg. Sipas këtij vendimi, që u mor në takimin e Këshillit të Atlantikut të Veriut të mbajtur në Bruksel më 4 korrik, Stoltenbergu do të mbetet në krye të aleancës deri më 1 tetor 2024.

Me këtë vendim iu dha fund spekulimeve lidhur me zgjedhjen e mundshme të pasardhësit të Stoltenbergut në krye të NATO-s.

Stoltenbergu i ka falënderuar shtetet anëtare për besimin e dhënë. "Jam i nderuar nga vendimi i aleatëve në NATO për ta vazhduar mandatin tim sekretar të përgjithshëm. Lidhja transatlantike mes Evropës dhe Amerikës së Veriut e ka siguruar lirinë dhe sigurinë tonë për gati 75 vjet dhe në një botë shumë më të rrezikshme, kjo aleancë është më e rëndësishme se kurrë më parë", tha ai.

Ka pasur përpjekje që deri në samitin e NATO-s, që do të mbahet në Vilnius më 11 dhe 12 korrik, të arrihej pajtim mes aleatëve për sekretarin e ri të përgjithshëm. Por, duke pasur parasysh situatën globale dhe sfidat me të cilat po përballet hapësira euroatlantike, është vendosur që Stoltenbergut t'i vazhdohet mandati edhe për një vit.

Vendimi për emërimin e shefit të NATO-s merret me konsensus të 31 shteteve anëtare.

Kjo është hera e katërt që i zgjatet mandati Stoltenbergut dhe më 2024 do të bëhen dhjetë vjet që ai do të jetë në krye të aleancës.

Më herët gjatë këtij viti, Stoltenbergu deklaroi se nuk ishte i interesuar të mbetet në postin e sekretarit të përgjithshëm pasi t'i skadonte mandati i fundit. Ai veçse ishte emëruar edhe president i Bankës Qendrore të Norvegjisë. Por, tani ai ka pranuar vendimin e shteteve të NATO-s dhe do të mbetet në krye të aleancës deri në tetorin e vitit



të ardhshëm. Aleatët e kanë falënderuar Stoltenbergun për udhëheqjen e tij, për përkushtimin e treguar për ruajtjen e unitetit transatlantik

në kohën kur bota po përballet me një prej sfidave më të paprecedentë të sigurisë, pasi Rusia shkurtin e kaluar nisi pushtimin e Ukrainës.

Vendimin e Këshillit të Atlantikut të Veriut do ta konfirmojnë edhe liderët e vendeve anëtare në samitin e tyre në Vilnius të Lituanisë.

Bota shënon temperatura rekorde në tokë dhe dete

BON, 4 KORRIK - Synimi që ndryshimet klimatike të mos lejohen të shkaktojnë ndryshime të temperaturës mbi 1.5 gradë Celsius në krahasim me kohën para-industriale është duke u bërë i paarritshëm, thonë ekspertët të ambientit. Ata shprehen të shqetësuar që shtetet nuk kanë arritur të vendosin caqe ambicioze për klimën pavarësisht se janë shënuar temperatura rekorde në tokë dhe dete.

Teksa përfaqësues të shumë vendeve u mbledhën në Bon të Gjermanisë për t'u përgatitur për negociatat vjetore për klimën, që do të mbahen në nëntor, temperaturat mesatare globale të ajrit ishin, për disa ditë rresht, mbi 1.5 gradë Celsius më të larta se temperaturat e kohës para-industriale, tha Shërbimi i Ndryshimeve Klimatike Copernicus (C3S) i financuar nga Bashkimi Evropian.

Megjithëse temperaturat mesatare kishin kaluar përkohësisht pragun prej 1.5 gradëve Celsius edhe në të kaluarën, kjo është hera e parë që ky ndryshim është regjistruar gjatë periudhës së verës në hemisferën veriore të Tokës. Temperaturat në dete gjithashtu thyen rekordet e prillit dhe majit. "Neve na ka mbaruar koha sepse edhe ndryshimi kërkon kohë", tha


Sarah Perkins-Kirkpatrick, një klimatologe në Universitetin Australian të Uellsit të Ri Jugor.

Përderisa të dërguarit e dy shteteve që emetojnë më së shumti gazra serrë, ShBA-së dhe Kinës, përgatiten të takohen muajin e ardhshëm, rekordet për temperaturat më të larta gjatë muajit qershor u thyen në kryeqytetin kinez, Pekin, ndërsa valët ekstreme të të nxehtëit kanë goditur Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Pjesë të Amerikës së Veriut ishin rreth 10 gradë celsius mbi mesataren sezonale në qershor dhe tymi nga zjarret e pyjeve mbuloi Kanadanë dhe bregun lindor të ShBA-së. Emetimet e karbonit vlerësohet se arritën një rekord prej 160 milionë tonë metrikë.

Në Indi, një nga rajonet më të rrezikuara nga ndryshimet klimatike, vdekjet u raportuan të jenë rritur si rezultat i temperaturave të larta. Nxehtësi ekstreme është raportuar edhe në Spanjë, Iran dhe Vietnam, duke rritur frikën se vera vdekjeprurëse e vitit të kaluar mund të kthehet në një rutinë.

Liderët e shteteve kishin rënë dakord në Paris në vitin 2015 që të përpiqen t'i mbajnë rritjet mesatare afatgjata të temperaturës brenda 1.5 gradë



Celsius, por tani ka një mundësi prej 66-përqindësh që mesatarja vjetore të kalojë këtë prag, sipas parashikimeve të Organizatës Botërore Meteorologjike në maj. Temperaturat mesatare globale të sipërfaqes së detit arritën në 21 gradë Celsius në fund të marsit dhe kanë mbetur në nivele rekorde gjatë gjithë prillit dhe majit. Agjencia e motit në Australi paralajmëroi se temperaturat e deteve të Paqësorit dhe Oqeanit Indian mund të jenë 3 gradë

Celsius më të ngrohta se zakonisht deri në tetor.

Ngrohja globale është faktori kryesor, tha Piers Forster, profesor i fizikës klimatike në Universitetin e Leeds, por El Nino, rënia e pluhurit të Saharës mbi oqean dhe përdorimi i karburanteve të transportit me squfur të ulët kanë ndikuar gjithashtu. "Pra, në përgjithësi, oqeanet po sulmohen nga një goditje e katërfishtë", tha ai. "Është një paralajmërim për gjërat që na presin".

Mijëra peshq të ngordhur u shfaqën në plazhet e Teksasit, ndërsa lulëzimi i algave të shkaktuara nga nxehtësia është cilësuar si faktor kryesor i vrasjes së luanëve të detit dhe delfinëve në Kaliforni.

Detet më të ngrohta mund të nënkuptojnë më pak erë dhe shi, duke krijuar një rreth vicioz që çon në edhe më shumë nxehtësi, tha Annalisa Bracco, një klimatologe në Institutin e Teknologjisë në Gjeorgji.

Clintoni jep mesazh në Tiranë: Duhet t'i ndalim marrëzitë në veri të Kosovës

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

TIRANË, 4 KORRIK - Ish-presidenti i ShBA-së, Bill Clinton, kërkoi t'i jepet zgjidhje situatës në veri të Kosovës, të cilën e cilësoi si "marrëzi". Në fjalimin e tij para zyrtarëve të lartë të Shqipërisë dhe qytetarëve të mbledhur për nder të tij në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" në Tiranë, ai theksoi se duhen mbajtur sa më shpejt zgjedhjet në veri. "Ka një mosmarrëveshje që po ndodh tani në Kosovë që do të dëshiroja të mos kishte ndodhur kurrë. Nuk është më vendimi im, por kosovarët i krijuan ato katër qyteza në të mirë të serbëve për t'u dhënë katër kryetarë komunash më tepër, kështu që mendoj se tani kanë bërë një gabim duke mos votuar. Mendoj se është e lehtë për shqiptarët, tashmë në shumicë, që të përpiqen të përfitojnë nga momenti për ta paraqitur argumentin e tyre, por gjëja e vërtetë që duhet të bëjmë është që duhet ta ndalim këtë marrëzi. Çfarë çështje e madhe politike mund të avancohet duke pasur tension? Ka njerëz që jetojnë aty. Kanë nevojë të kenë një qeverisje të denjë dhe qytetarët kanë nevojë t'u thuhet 'ju duhet të votoni' gjithmonë", ka thënë ish-presidenti amerikan. Serbët lokalë në katër komunat në veri të Kosovës i kishin bojkotuar zgjedhjet e mbajtura në prill, duke bërë që kryetarë në

ato komuna me shumicë serbe të zgjedhen katër shqiptarë. Tensionet në këto komuna janë ngritur që nga 26 maji, kur autoritetet e Kosovës i ndihmuan kryetarët e rinj të hyjnë në objektet komunale. Faktori ndërkombëtar ka bërë thirrje për shtensionim të situatës.

pari t'i tregojë botës se si duket një e ardhme gjithëpërfshirëse", ka thënë Clintoni. Të pranishëm në pritjen për nder të ish-presidentit Bill Clinton ishin përfaqësues të qeverisë shqiptare, ambasadorë të akredituar në Tiranë, përfaqësues të opozitës,

me "Yllin e Mirënjohjes për Arritjet Publike". "Jam pa fjalë. Mendoj se po të kisha një gjykim shumë të shëndoshë, nuk do të thosha asgjë. Jam me të vërtetë pa fjalë", tha Clintoni në ditën e parë të qëndrimit të tij dyditor në Shqipëri me ftesë të kryeministrit shqiptar, Edi Rama.

se ai fjalim ishte "për historinë e Kosovës dhe rajonin tonë, një gur përcaktues i rrugës të së ardhmes". Ai, gjithashtu, theksoi disa nga ndihmat që ShBA-ja, gjatë administratës së Clintonit, ia dha Shqipërisë të sapodalë nga regjimi komunist.

Kjo është vizita e parë e Bill Clintonit në Tiranë, ndërkaq 11 vjet më parë Shqipërinë e pati vizituar bashkëshortja e tij, Hillary Clinton, që atëbotë mbante postin e sekretares së Shtetit. Clintoni ishte president i ShBA-së në kohën kur po zhvillohej lufta në Kosovë dhe ai luajti rol kyç që NATO t'i niste bombardimet ndaj caqeve serbe, që çuan në çlirimin e Kosovës. Atëbotë Clintoni kishte deklaruar se vendimi për nisjen e bombardimeve ishte marrë për t'i mbrojtur mijëra njerëz të pafajshëm në Kosovë nga regjimi i liderit të atëhershëm serb, Slobodan Millosheviq. Clintoni ka vizituar për herë të parë Kosovën në maj të vitit 1999. Ai, po ashtu, qëndroi në Kosovë edhe më 2009 dhe 2019. Në vizitën e tij të fundit, ai ishte i shoqëruar me ish-sekretaren e ndjerë amerikane, Madeleine Albright. Ata morën pjesë në ceremoninë e mbajtura për 20-vjetorin e hyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë, që shënohet si Dita e Çlirimit.

Trupat paqeruajtëse të NATO-s hynë në Kosovë më 12 qershor 1999, pas fushatës ajrore të aleancës kundër caqeve serbe në Kosovë dhe Serbi që zgjati 78 ditë.



Clintoni, gjithashtu, tha se është i bindur që ShBA-ja është "e angazhuar për lirinë, forcën dhe integritetin e Shqipërisë", përkundër që nuk ka ndonjë rol në administratën aktuale të ShBA-së. "Unë shpresoj që Shqipëria në mënyra të mëdha e të vogla do të jetë në gjendje që së

pushtetit lokal, komuniteteve fetare. Por, pjesë e kësaj ceremonie u bënë edhe disa të rinj dhe fëmijë kosovarë, që mbajnë emrin Clinton dhe të bashkëshortes së tij Hillary. Ai u shpreh shumë i emocionuar nga falënderimet që mori gjatë ceremonisë, në të cilin u dekorua

Gjatë fjalimit të tij, Rama tha se ai vetë e ka pasur shembull Clintonin dhe e lavdëroi atë për rolin e tij në përfundimin e luftës në Kosovë. Rama e quajti fjalimin e Clintonit në mars të vitit 1999, kur lajmëroi për ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë, "një tjetër perlë" dhe tha





KRYEMINISTRI I HOLANDËS DHE AI I LUKSEMBURGUT VIZITOJNË KOSOVËN

Holanda dhe Luksemburgu: Të përmbushen kërkesat e BE-së për shtensionimin e situatës në veri

Kryeministri i Holandës, Mark Rutte, dhe ai i Luksemburgut, Xavier Bettel, kanë kërkuar nga Kosova t'i përmbushë tri kushtet e BE-së për shtensionimin e situatës në veri të Kosovës. Në një konferencë të përbashkët për medie me kryeministrin Albin Kurti në Prishtinë, ata kanë thënë se shtensionimi i situatës në veri është në interes të paqes dhe stabilitetit rajonal. Ata kanë kërkuar nga Kosova dhe Serbia që t'i kthehen dialogut. Ndërsa kryeministri Kurti ka thënë se Kosova dëshiron raporte të mira fqinjësore me Serbinë, por ka kërkuar të zbatohet marrëveshja drejt normalizimit, të cilën e kanë nënshkruar gjatë këtij viti

**EPOKA
ERE**

Lirim GECI

PRISHTINË, 4 KORRIK - Kryeministri holandez Mark Rutte dhe ai i Luksemburgut, Xavier Bettel, të martën kanë qëndruar në Kosovë. Ata janë pritur në takime të ndara nga presidentja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti. Pas aterimit në Prishtinë, në aeroportin "Adem Jashari" ata janë pritur me ceremoni shtetërore nga kryeministri Kurti. Pas pritjes shtetërore, dy kryeministrat janë nisur për ta takuar fillimisht presidenten Osmani, më pas kryeministrin Kurti, me të cilin kanë mbajtur një konferencë të përbashkët për

medie.

Në këtë konferencë të dy kryeministrat evropianë kanë kërkuar që Kosova t'i përmbahet planit të Bashkimit Evropian (BE) për shtensionimin e situatës në veri të Kosovës.

Kryeministri i Holandës, Mark Rutte, ka theksuar se mënyra më e mirë për ta shtensionuar situatën në veri është që palët (Kosova dhe Serbia) t'i përmbushin kërkesat e paraqitura nga Bashkimi Evropian, duke shtuar se stabiliteti rajonal është çështje shumë e rëndësishme. "Sot kemi shprehur brengat tona për rritjen e tensioneve në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe Holanda e

Luksemburgu tentojnë që përmes dialogut të shtensionohet situata dhe të normalizohen raportet në mes të dy shteteve. Kjo është e rëndësishme jo vetëm për paqen dhe stabilitetin në rajon, por edhe për prosperitetin e integritetit drejt BE-së", ka thënë kryeministri holandez.

Edhe kryeministri i Luksemburgut, Xavier Bettel, ka bërë thirrje për uljen e tensioneve në veriu të Kosovës, duke theksuar se të gjitha palët duan që situata të shtensionohet. "Udhërrëfyesi nga (i dërguari i BE-së për dialogun, Miroslav Lajçaku dhe (shefi i diplomacisë së BE-së, Joseph) Borrelli

paraqet, po ashtu, për ne hapat e rëndësishëm për të vazhduar përpara. Ne duhet ta shmangim çdo krizë të re të mundshme", ka thënë Bettel.

Ndërsa kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se Kosova dëshiron raporte të mira fqinjësore me Serbinë. Në këtë kontekst, ai ka thënë se për këtë kërkohet të zbatohet marrëveshja drejt normalizimit, të cilën e kanë arritur gjatë këtij viti. "Ne dëshirojmë zgjidhje evropiane dhe për këtë e kemi marrëveshjen bazë të 27 shkurtit dhe aneksin e zbatimit të 18 marsit që dëshirojmë të zbatohet plotësisht, pa vonesa dhe pa kushte", ka thënë Kurti.

Kurse gjatë takimit të dy liderëve evropianë me presidenten Vjosa Osmani, kjo e fundit ka thënë se Kosova ka "demonstruar vullnet" për shtensionimin e situatës, duke "ofruar organizimin e zgjedhjeve të reja në veri të vendit". "Presidentja Osmani tha se Kosova ka demonstruar vullnet për deeskalim, duke ofruar organizimin e zgjedhjeve të reja në veri të vendit dhe se

vendosja e rendit dhe e ligjit është në përputhje me investimin ndër vite të shteteve të BE-së me qëllim të promovimit, mbrojtjes dhe sundimit të ligjit në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Në takim, presidentja Osmani ka shprehur përkushtimin e institucioneve të Kosovës që sfidat t'i tejkalojnë me partnerë dhe aleatë", ka njoftuar zyra e presidentes Osmani.

Më tutje, sipas këtij njoftimi, Osmani ka potencuar se sulmet ndaj Policisë së Kosovës, EULEX-it, KFOR-it, qytetarëve dhe gazetarëve nga strukturat ilegale dhe kriminale në veri të vendit, nuk duhet të mbeten pa u ndëshkuar.

Kurse në raport me procesin e dialogut me Serbinë, presidentja Osmani ka thënë se Kosova vazhdon të jetë palë konstruktive, derisa Serbia refuzon zbatimin e marrëveshjeve të arritura, sikurse edhe shkelë marrëveshjen e fundit të Brukselit të arritur në Ohër.

BE-ja përjashton Kosovën, Malin e Zi dhe entitetin e Republikës Sërpska nga grantet

PRISHTINË, 4 KORRIK - Kosova, Mali i Zi dhe entiteti i Republikës Sërpska në Bosnjë-Hercegovinë kanë mbetur jashtë granteve që Bashkimi Evropian ka miratuar për projektet në kuadër të Kornizës për Investime në Ballkanin Perëndimor.

Nga këto investime përfituan Serbia, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Bosnjë-Hercegovina, përkatësisht Federata boshnjako-kroate.

Korniza Investuese e Ballkanit Perëndimor është një iniciativë e përbashkët e BE-së, institucioneve financiare dhe donatorëve, që synon zhvillimin socio-ekonomik dhe të perspektivës evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Vlera e përgjithshme e kornizës është 2.1 miliardë euro.

Kosova nuk ka përfituar nga grantet e bllokut evropian, pasi BE-ja në fund të qershorit vendosi masa ndëshkuese ndaj Prishtinës për shkak të mospërbushjes së kërkesave të Brukselit për shtensionimin e situatës në veri të Kosovës.

Në mesin e masave ndëshkuese është edhe pezullimi i të gjitha programeve financiare të BE-së. Në shkurt të këtij viti Qeveria e Kosovës kishte thënë se kishte aplikuar edhe për dy grante investuese dhe katër grante të asistencës teknike në Kornizën Investuese, por nuk kishte specifikuar më shumë në lidhje me to.

Kosova ka përfituar nga ky mekanizëm që nga viti 2009. Deri më 2021 kjo kornizë ka

mbështetur 30 projekte në Kosovë në vlerë prej 1.8 miliard eurosh.

Projektet përfshijnë ndërtimin e rrugëve, rehabilitimin e hekurudhave, sistemet e ngrohjes qendrore dhe përmirësimin e sistemit të ujërave të zeza.

Për vitet 2023-2030, në kuadër të këtij mekanizmi, në Kosovë janë paraparë edhe projekte të tjera, si: Autostrada e Paqes Prishtinë - Nish, rruga hekurudhore Beograd - Prishtinë, ngrohja diellore për Prishtinën, impianti për trajtimin e ujërave të zeza për Prishtinën e të tjera.

Mali i Zi me projekte "të papërshtatshme"

As Mali i Zi nuk ka përfituar grantet e bllokut, pasi projektet e paraqitura nga Podgorica, nga Komisioni Evropian, janë parë si të "parakohshme dhe të papërshtatshme". "Mali i Zi ka paraqitur projekte investimi në fushën e energjisë, mjedisit dhe transportit që janë vlerësuar nga Korniza për Investime në Ballkanin Perëndimor si të parakohshme për financim ose të papërshtatshme për financim", konfirmoi zëdhënësjja e KE-së, Ana Pisonero, nëpërmjet një përgjigjeje me shkrim për mediet. Ajo shtoi se shpreson që Podgorica ta vazhdojë përgatitjen dhe maturimin e këtyre propozimeve për investime për paraqitjen e serishme të tyre në thirrjet e reja në kuadër të



Kornizës për Investime në Ballkanin Perëndimor. Pisonero konfirmoi se Mali i Zi përfiton nga tri projekte të asistencës teknike, në vlerë prej 3.5 milionë eurosh, në kuadër të kësaj thirrjeje për përgatitjen e investimeve në sektorët e transportit dhe energjisë.

Më 30 qershor KE-ja kishte njoftuar për miratimin e 14 projekteve kryesore investuese në fushën e transportit, energjisë, mjedisit, kapitalit njerëzor dhe mbështetjes për sektorin privat në Ballkanin Perëndimor.

Entiteti serb s'përfiton asnjë grant

Grante në vlerë prej 303 milionë eurosh janë miratuar

edhe për projektet infrastrukturore në Bosnjë-Hercegovinë, por të gjitha grantet do të përqendrohen në Federatën boshnjako-kroate dhe jo në entitetin e Republikës Sërpska.

Grantet, pjesë e paketës së investimeve prej 2.1 miliardë dollarësh të BE-së për Ballkanin Perëndimor, do të ndihmojnë disa projekte, përfshirë ndërtimin e dy seksioneve të autostradës panevropiane që lidh Budapestin me portin kroat të Ploçes.

Projektet e tjera në Bosnjë, që do të mbështeten nga këto grante, kanë të bëjnë me përmirësimin e furnizimit me ujë në Sarajevë dhe rehabilitimin e një pompe depozituese në një hidrocentral

në jug të shtetit.

Bashkimi Evropian e kishte paralajmëruar presidentin e Republikës Sërpska, Millorad Dodik, që ta ndalë retorikën secensioniste dhe lëvizjet që minojnë shtetin e Bosnjës.

Delegacioni i BE-së në Bosnjë-Hercegovinë nuk u është përgjigjur pyetjeve të Radios Evropa e Lirë se pse nuk janë mbështetur projektet në Republikën Sërpska.

Fondet e miratuara janë mbi gjysma e 528 milionë eurove që janë miratuar për rajonin në formë të granteve nga Instrumentet e Para-Anëtarësimit (IPA), së bashku me disa kontribute të shteteve të bllokut dhe Norvegjisë, por edhe kreditë nga institucionet ndërkombëtare financiare.



Kryeministri i Holandës, Mark Rutte, dhe ai i Luksemburgut, Xavier Bettel, kanë qëndruar edhe në Beograd, ku kanë zhvilluar bisedime me krerët shtetërorë serbë. Kjo vizitë e dy kryeministrave evropianë ishte planifikuar disa muaj më herët. Por, ata këtë vizitë e kanë shfrytëzuar për ta dërguar mesazhin e Bashkimit Evropian dhe bashkësisë ndërkombëtare për uljen e tensioneve në veri të Kosovës, për qetësimin e situatës në atë zonë dhe

kthimin e Prishtinës dhe Beogradit në dialogun e Brukselit.

Në Beograd, Bettel ka thënë se shpreson që në ditët dhe javët në vijim të arrihet përparim "dhe të ketë shtensionim të situatës", duke shtuar se shpreson që nuk do të ketë nevojë të flitet më për presione që duhet t'u bëhen palëve për ta zgjidhur këtë situatë. BE-ja ka pezulluar përkohësisht punën e të gjitha grupeve punuese për MSA-në, ftesat për

pjesëmarrjen e Kosovës në takime të nivelit të lartë, programimin e fondeve për Kosovën, përfshirë ato nga IPA dhe nga Korniza Investuese e Ballkanit Perëndimor. Kurse Rutte ka thënë se është e rëndësishme që të përmbushen kërkesat e paraqitura nga BE-ja pasi, sipas tij, plotësimi i tyre është rruga më e shpejtë që do të çojë drejt shtensionimit. BE-ja është duke kërkuar tërheqjen e njëjësive speciale të Policisë së Kosovës nga afërsia e

ndërtesave komunale në veri, paralelisht me tërheqjen e protestuesve serbë. Po ashtu, blloku evropian ka kërkuar tërheqjen e kryetarëve të rinj nga ndërtesat komunale, shpalljen e zgjedhjeve në veri dhe zotimin publik të serbëve se do të marrin pjesë në votime. Në këtë vizitë ishte paraparë të merrte pjesë edhe kryeministri i Belgjikës, Alexander De Croo. Por, ai e ka anuluar pjesëmarrjen për shkak të një krize të brendshme politike.

Vizita e kryeministrit të Holandës dhe atij të Luksemburgut vjen në kohën kur tensionet në mes të Kosovës dhe Serbisë janë rritur. Tensionet janë rritur në fund të majit në Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq - komuna të banuara me shumicë serbe - pasi serbët lokalë janë duke i kundërshtuar kryetarët e rinj shqiptarë. Kryetarët e rinj shqiptarë janë zgjedhur në zgjedhjet e prillit, votime që janë bojkotuar nga partitë dhe popullata lokale serbe.



500 000 euro grante për fermeret e Ferizajt

FERIZAJ, 4 KORRIK - Komuna e Ferizajt deri në fund të këtij viti do të ndajë rreth gjysmë milioni euro grante për gratë fermere.

Kryetari i kësaj komune, Agim Aliu, ka njoftuar se 150 000 euro u janë shpërndarë ditë

më parë grave fermere. “Si rrjedhojë e bashkëpunimit të Drejtorisë së Bujqësisë me organizatën BMZ, deri në fund të këtij viti, përtej skemës së mbështetjes me subvencione nga komuna, gratë fermere do të përfitojnë grante në vlerën

afro 450,000 euro për ta zhvilluar veprimtarinë e tyre bujqësore, 150,000 euro prej të cilave u shpërndanë ditë më parë, gjersa pjesa tjetër shpërndahet deri në fund të vitit”, ka shkruar Aliu në “Facebook”.



Mbi 2.5 milionë euro për ndërtimin e Qendrës Rezidenciale për të moshuar në Podujevë

PODUJEVË, 4 KORRIK - Një ditë më parë në Kuvendin Komunal është miratuar propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Qendrës Rezidenciale për qëndrim ditore për të moshuarit e komunës së Podujevës.

Ky objekt do të ndërtohet në bashkëfinancim në mes të komunës së Podujevës (530 mijë) dhe Shoqatës “Jetimat e Ballkanit” (2 milionë euro). Për pak ditë do të nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit në mes të komunës dhe shoqatës për implementimin e këtij projekti, kurse së zbatuari do të

fillojë sivjet dhe përfundon vitin e ardhshëm.

Objekti, përveç qëndrimit ditore për të moshuar, do ta ketë edhe kuzhinën popullore për ofrimin e shujtave ditore për 200 persona, hapësira rekreative, parkun, shërbimin parësor shëndetësor, dhoma fizioterapeutike etj. Kryetari i komunës, Shpejtim Bulliqi, shpreh falënderim për hoxhën Halil Kastrati, donatorët e shoqatës, si dhe i ka falënderuar edhe asamblistët e Kuvendit për miratimin e propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e këtij objekti në qytetin e Podujevës.



Hyseni dhe Krasniqi nënshkruajnë marrëveshje bashkëfinancimi për një projekt në Gjilan



GJILAN, 4 KORRIK - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka nënshkruar marrëveshje bashkëfinancimi me ministrin e

Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi. Kjo marrëveshje ka për objekt bashkëfinancimin e projektit

“Regjenerimi i ish-parkingut duke integruar xhepat e gjelbër - Parku Urban në komunën e Gjilanit”. Kryetari Hyseni e ka falënderuar

me këtë rast ministrin Krasniqi për bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme për Gjilanin. Ai bëri me dije se shuma totale e këtij

projekti është mbi 100 mijë euro, ku MAPL ndan 90 mijë euro, ndërkaq komuna e Gjilanit 11 890.00 euro.

Fillon dezinfektimi në qytetin e Prizrenit

PRIZREN, 4 KORRIK - Ka filluar implementimi i fazës së parë të dezinfektimit të qytetit të Prizrenit dhe zonave periferike. Me këtë

plan synohet eliminimi ose sjellja në kufi të tolerancës epidemiologjike të insekteve fluturuese (sidomos mizat dhe mushkonjat), pengimi i

përhapjes së sëmundjeve që përhapen nga këto insekte dhe krijimi i kushteve për një jetë më të rehatshme gjatë stinës së verës.

Komuna ka njoftuar se faza e dytë e këtij procesi realizohet pas 21 ditësh dhe ka qëllim ruajtjen e shëndetit publik.



ShBA-ja shënon 247-vjetorin e Pavarësisë, Kosova e uron dhe e falënderon për përkrahje

PRISHTINË, 4 KORRIK - Më 4 Korrik të vitit 1776 ShBA-ja shpalli pavarësinë e saj. Kongresi Kontinental miratoi bashkërisht Deklaratën e Pavarësisë, një dokument përmes të cilit kolonitë amerikane njoftuan shkëputjen nga Britania e Madhe. Për 247 vjet shtetësi, ShBA-ja arriti të kthehet në vendin më të fuqishëm të botës.

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Jeff Hovenier, ka uruar Ditën e Pavarësisë së ShBA-së. Hovenieri ka thënë se në këtë ditë, 247 vjet më parë, themeluesit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës kanë deklaruar të drejtat e patjetërsueshme. “Sot amerikanët në Shtetet e Bashkuara dhe në mbarë globin festojnë Ditën e Pavarësisë së kombit tonë. Në këtë ditë 247 vjet më parë themeluesit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës deklaruan të drejtat e patjetërsueshme të jetës, lirisë dhe kërkimit të lumturisë. Gëzuar

4 Korrikun!”, ka shkruar Hovenier në “Twitter”.

ShBA-në për këtë ditë e kanë uruar edhe udhëheqësit e shtetit të Kosovës dhe liderët e partive opozitare.

Kryeministri Albin Kurti ka theksuar se aleanca me ShBA-në është e përrjetshme. “ShBA-të festojnë plot 247 vite vlera demokratike të shtetit dhe popullit amerikan. Janë burim frymëzimi për botën demokratike. Jetësojnë vizionin më të fuqishëm të lirisë dhe barazisë. Vizion dhe vlera të përbashkëta që përbëjnë edhe themelin e aleancës së shteteve e kombeve tona. Ashtu si ai vizion është i përrjetshëm, po ashtu është edhe aleanca e jonë. Gëzuar 4 Korrikun!”, ka shkruar Kurti në “Facebook”.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka theksuar se Deklarata e Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës shënonte fitoren në ardhje jo vetëm për popullin amerikan, por edhe për të gjithë



botën, e cila do të futej në procesin e gjatë dhe të pakthyeshmë drejt vlerave universale që promovoi ajo deklarate pavarësie dhe që kultivuan institucionet amerikane të ngritura mbi ato themele. “Gëzuar 4 Korrikun, kombit amerikan, gjithë botës demokratike dhe atyre që përkasin në vlerat e saj!”, ka shkruar Konjufca në “Facebook”.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka theksuar se përpjekjet tona për

çlirim dhe pavarësi u finalizuan suksesshëm me ndihmën dhe mbështetjen e pakushtuar të ShBA-së. “Me diplomaci të përkushtuar, politikë të vendosur dhe angazhim të vazhdueshëm, ShBA-të u bënë zëri i drejtësisë për popullin e Kosovës. Para, gjatë dhe pas luftës për liri. Edhe sot e kësaj dite! PDK mbetet tejet e përkushtuar në ruajtjen dhe forcimin e miqësisë dhe aleancës së shenjtë mes popujve dhe shteteve tona. Gëzuar 4 Korrikun!”, ka shkruar Krasniqi

në “Facebook”.

Edhe Lidhja Demokratike e Kosovës e ka uruar ShBA-në për Ditën e Pavarësisë. “Në kohët më të vështira ShBA-të mbështetën Kosovën falë vizionit politik e largpamës të Presidentit Rugova i cili krijoi urat e komunikimit me Amerikën dhe i artikuloj ato në mënyrën më të mirë të mundshme në funksion të lirisë dhe shtet-formimit të Kosovës. Për këtë u jemi mirënjohës përherë! Urime Dita e Pavarësisë ShBA!”, është thënë në urimin e LDK-së.

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, në këtë ditë ka thënë se ShBA-ja është inspirim për popullin e Kosovës. “Amerikë, urime ditëlindjen! Je gjithmonë inspirim për ne. Do të ishte në nderin e Kosovës që 4 Korriku të shpallet festë shtetërore”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”. Në rrjete sociale qytetarë të shumtë e kanë uruar ShBA-në për 247-vjetorin e Pavarësisë, duke e falënderuar për përkrahjen e vazhdueshme që ka dhënë për Kosovën.

Vetëvendosja sërish sulmon opozitën: Për 20 vjet e mbajti të izoluar Kosovën



PRISHTINË, 4 KORRIK - Partia e Albin Kurtit, Lëvizja Vetëvendosje, sërish e ka sulmuar opozitën me një video të re. IV-ja në faqen e saj në “Facebook” ka publikuar një video me një shkrim me titull: “Kjo opozitë me koordinim a pa koordinim?!”. Vetëvendosja e akuzon opozitën aktuale për izolim të vendit që 20 vjet. Sipas kësaj partie, është mirë që kjo opozitë nuk është në qeveri, se do ta dorëzonte vendin para Serbisë. “Opozita flet për izolim, ndërkohë që sa ishte në pushtet fali tokë, nënshkroi ‘Zajednicë’, shiti e vodhi pasuri publike, duke na mbajtur për 20 vjet të izoluar. Flet për fonde, tash kur i mban 150

milione euro të bllokuara duke mos i votuar marrëveshjet ndërkombëtare në Kuvend. Flet për çmime të larta, ndërkohë që e ka dërguar Ligjin për Çmimet Tavan në Gjykatë Kushtetuese. Mirë që kjo opozitë nuk është në qeveri, se do ta dorëzonte vendin para Serbisë siç dëshmoi së fundi me kërkesën e tyre (të njëjtë me Serbinë) që të largohen kryetarët legjitimë nga objektet komunale në pjesën veriore dhe të organizohen zgjedhje të reja”, thuhet në mesazhin e IV-së, partisë së kryeministrit Albin Kurti.

Ndaj kësaj videoje ka reaguar nënkryetarja e PDK-së, Vlora

Çitaku, e cila ka theksuar se IV-ja është në panik. “S’ju ka mbetur tjetër përveç videove me propagandë, shpifje e thjeshtëzime banale. Ujë në mulli të Vuçiqit po dërgon vetë Albin Kurti, me qasjen e tij aventureske e të papërgjegjshme. Interes i kujt, pos i Serbisë, është sanksionimi i Kosovës nga aleatët e armiqësimi ynë me gjithë botën? Interes i kujt është pushtimi i medieve botërore me tituj që e përshkruajnë Kosovën si vatrë krize, të polarizuar nga brenda e të izoluar nga jashtë? Ndërkohë për zgjedhje të reja, jemi gati që sot. Mos u tutni”, ka shkruar Çitaku në “Facebook”.

Hapet edicioni i 22-të i Universitetit Veror të Prishtinës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 KORRIK - Më shumë se 300 studentë vendorë dhe ndërkombëtarë e nisën rrugëtimin e tyre në Universitetin Veror Ndërkombëtar të Prishtinës.

Në ceremoninë e hapjes së UVP-së, të mbajtur në bulevardin “Xhorxh Bush”, morën pjesë drejtuesit e UP-së, përfaqësues nga institucionet qeverisëse qendrore dhe lokale, partnerë të UP-së, profesorë dhe studentë.

Studentëve dhe profesorëve pjesëmarrës në UVP u uroi mirëseardhje rektori Qerim Qerimi. “Kemi përgatitur 14 kurse për ju, ku secili prej tyre përfaqëson

diversitetin e njësive tona akademike. Universiteti Veror i Prishtinës nuk është vetëm një ngjarje akademike. Është një dëshmi e përpjekjes së vazhdueshme të universitetit tonë për ta udhëhequr Evropën Juglindore në ofrimin e mundësive të shkëlqyera të arsimit të lartë”, ka thënë rektori Qerim Qerimi.

Nisjen e UVP-së e uruan edhe kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, sekretari i përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Behar Isma, Bora Shpuza nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Nora Latifi nga bordi i Shkëmbimit Arsimit Shtetëror dhe Bashkuara të



Amerikës - Kosovë (USKEB). UVP-ja do ta mbajë programin e saj deri më 14 korrik 2023.

Gjatë këtyre ditëve të universitetit veror, përveç kurseve akademike, do të mbahen punëtori,

ekskursione, mbrëmje argëtuese me muzikë dhe filma e shumë aktivitete të tjera.

Auditorja e përgjithshme: S'ka auditim në katër komunat veriore



Prishtinë, 4 korrik - Auditorja e përgjithshme Vlora Spanca gjatë prezantimit të çështjeve kryesore të paraqitura në raportet e auditimit për vitin 2022 ka thënë se për shkak të situatës së krijuar në veri, Zyra Kombëtare e Auditimit nuk ka arritur të bëjë auditimin në Mitrovicën e Veriut, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq. Spanca ka theksuar se nga 97 opinione të dhëna, 39 janë të modifikuara, që do të thotë se janë opinione jo të mira. “Në

kuadër të auditimeve mandatore me ligj nga auditimet e rregullsisë nga 101 entitete publike janë mbuluar 97 prej tyre. Ju njoftoj se për katër komunat veriore, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan, ne edhe pse kemi iniciuar auditimin, për shkak të rrethanave të krijuara, nuk kemi mundur ta zhvillojmë auditimin”, theksoi Spanca. Kryeauditorja ka theksuar se krahasuar me një vit më parë,

rezultojnë se cilësia e raportimit financiar është përmirësuar dhe ka zvogëlim të numrit të opinionëve të modifikuara. “Për secilin entitet publik ne kemi dhënë individualisht opinione të auditimit. Nga 97 opinione të dhëna, 58 janë të pamodifikuara, që do të thotë se janë 58 opinione të mira, ndërsa 39 janë opinione të modifikuara, që do të thotë se janë opinione jo të mira. Mbi këtë bazë 51 raporte të auditimit financiar të

pajtuësmerisë që kanë të bëjë me institucionet qendrore, përkatësisht ministri dhe institucione të pavarura, janë dhënë 39 opinione të pamodifikuara, 12 opinione të modifikuara përkatësisht të kualifikuara”, ka theksuar ajo, duke shtuar se në 34 komuna kanë dhënë 16 opinione të modifikuara përkatësisht të kualifikuara, 18 opinione të pamodifikuara, ndërsa te 12 ndërmarrjet publike janë dhënë 8 opinione të

kualifikuara, 3 opinione të kundërta dhe 1 opinion i pamodifikuara për pasqyrat vjetore financiare. “Krahasuar me një vit më parë rezultojnë se cilësia e raportimit financiar është përmirësuar. Kemi zvogëlim të numrit të opinionëve të modifikuara si 7 tek institucionet qendrore dhe 6 tek institucione lokale”, shtoi Spanca.

Megjithatë, Spanca ka thënë se edhe më tutje ekzistojnë parregullsi thelbësore në menaxhimin financiar të kontrollit. “Rezultatet tona kanë nxjerrë në pah se edhe më tutje ekzistojnë parregullsi thelbësore për menaxhimin financiar të kontrollit. Parregullsitë janë të përhapura pothuajse në secilin cikël dhe fushë të shpenzimeve. Po i përmendi vetëm disa prej atyre që janë kyçe. Në fushën e prokurimit publik, në auditimet e vitit 2022 janë identifikuar gjithsej 198 gjetje që përfshijnë kryesisht investimet kapitale dhe mallra e shërbime, si dhe janë evidente kryesisht te ministrinë dhe komunat”, përfundoi ajo.

Sipas auditores së përgjithshme, prej 97 auditimeve, 51 u takojnë institucioneve qendrore, 34 institucioneve lokale, 12 ndërmarrjeve publike, përfshirë këtu edhe Radio Televizionin e Kosovës.

Kurti: Kosova, një zgjidhje ideale për investitorët

PRISHTINË, 4 KORRIK - “Vendi ynë është padyshim evropian. Qeveria jonë është me gjithë zemër e përkushtuar ndaj vlerave evropiane siç janë demokracia dhe sundimi i ligjit, integrimi në organizatat evropiane si BE-ja dhe Këshilli i Evropës. Dhe ajo që vijon është vlerësimi dhe përkushtimi ynë i shumëfishtë: ne e vlerësojmë dialogun publiko-privat si një mjet për politika më të mira, ne u drejtohemi shoqatave të biznesit si aktorë dhe partnerë për ndryshim dhe mirëpresim kapitalin evropian si forcë lëvizëse për rritjen ekonomike në Kosovë”, kështu ka thënë kryeministri Albin Kurti në shënimin e përvjetorit të 9-të të themelimit të Këshillit të Investitorëve Evropianë.

Duke uruar Këshillin për këtë ditë të veçantë, kryeministri Kurti foli për mundësitë të cilat Republika e Kosovës i ofron, potencialin zhvillimor, punën dhe arritjet e qeverisë. Ai theksoi se qeveria ka marrë përsipër t'i kryejë reformat në mënyrë transparente dhe



demokratike, duke përfshirë angazhimin në dialog të rëndësishëm me sektorin privat. Sipas Kurtit, shoqatat e biznesit si Këshilli i Investitorëve Evropian marrin

pjesë në konsultime dhe seminare, të cilat i hartojnë me kujdes për ta inkurajuar komunikimin dhe për ta informuar vendimmarrjen. “Republika e Kosovës është një

zgjedhje ideale për investitorët. Vendndodhja jonë gjeografike, rinia e talentuar dhe qeveria e pastër krijojnë mundësi të shumta për të qenë pjesë e projekteve

transformuese. Rruga jonë është e qartë. Është ajo evropiane. Dhe ne ecm në këtë mision së bashku”, ka thënë Kurti në përmbyllje të fjalës së tij.

Qeveria e Kosovës, e sfiduar nga jashtë dhe nga brenda!



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

Tuneli pa asnjë dritë: Nuk ka qeveri në Kosovë që nga përfundimi i luftës e që është sjell në mënyrë më përbuzëse ndaj opozitës dhe medieve se kjo e fundit që po udhëhiqet nga Albin Kurti, kryeministër që e ka marrë rolin e Mesias dhe nuk njih tjetër përveç vetes së tij. Ndjenja e madhështisë i ka ndihmuar të fitojë mbi 50 për qind të votave dhe ka krijuar të gjitha mundësitë që të bëjë punë të mirë për Kosovën dhe qytetarët e saj, pa dallime partiake apo etnike. Karizma e tij e pakundërshtueshme e ka bërë politikanin që do të duhej të kishte peshë të rritur specifike edhe në vendet e tjera ku jetojnë shqiptarët, po të kishte qasje konstruktive. Përqindja e madhe e votave të fituara ia shtoi dukshëm adrenalinën e arrogancës, shpërfilljes dhe përbuzjes, në radhë të parë ndaj opozitës të cilën brutalisht e keqtrajtoi sikur edhe përkrahësve të orëve të para kur e kishte më së vështiri e që tash nuk pajtohen politikisht me këtë Mesia të hipotetiku nga mosdurimi dhe urrejtja! Se Albin Kurti ka kapacitet intelektual as dhe kundërshtari më i egër i tij nuk mund ta mohoi. Se ka kapacitet dhe shkathtësi oratorike, shihet gjatë çdo interviste apo debati me kundërshtarët politikë të cilët i sheh si armiq, në veçanti këta që e bënë luftën çlirimtare e që tani po mbahen si pengje në Burgun Racist të Hagës. Pas një kohe, kur të hapen letrat, do të shihet se kontributi i disa anëtarëve të LV-së, që çlirimtarët të dërgohen në Hagë, është bukur domethënës. Albin Kurti ka deklaruar publikisht se baba biologjik e ka Zaim Kurtin, kurse baba politik e ka Adem Demaçin. E para nuk kundërshtohet, kurse e dyta nuk është aspak e vërtetë. Albin Kurti nuk njih asnjë baba politik, por konsideron se është baba politikë i të gjithë shqiptarëve sikur edhe kosovarëve me prejardhje shqiptare. Krenaria e menaxhuar dhe e sinqertë t'i hapë të gjitha rrugët, kurse mendjemadhësia të kurthon edhe brenda brekëve tuaja. Albin Kurti është rast tipik për

këtë! Keqpërdorim i skajshëm i karizmës së pakontestuar, në funksion të dhunimit të kundërshtarëve politikë! Nuk ka politikan në historinë shqiptare dhe kosovare që ka pësuar një transformim apo shpërftyrim të tillë sikur që e ka bërë kryeministri Kurti duke i ndërruar të gjitha qëndrimet, premtimet elektorale apo parimet nëse këto i konsiderojmë si kategori morale. Po pse ndodhi kështu? As në ëndrrën më optimiste, Albin Kurti nuk ka besuar se do t'i fitojë mbi 50 për qind të votave. Kur kjo u jetësua nuk diti si të veprojë. Në vend se në postet politike të emërojë anëtarë të subjektit fitues që është edhe normale, ndërsa në postet profesionale të zgjedhë profesionistë të fushës, pa kritere politike, Albin Kurti e bëri lesh punën; në politikë zgjodhi kuadro që nuk marrin fare vesh nga politika, kurse në poste profesionale emëroi politikanë të dështuar, injorantë, ish-bashkëpunëtorë të Jugosllavisë dhe të Serbisë, spiunë të UDB-së, KOS-it dhe fundërrina njerëzore dhe kombëtare. Nuk kishte njerëz të mjaftueshëm kompetentë për t'i mbushur të gjitha ato poste dhe vende që ia siguruan mbi 50 për qind të votave prandaj mori çdokënd që ishte me të dhe që kundërshtonte luftën e sidomos ata që ishin kundër udhëheqësve të UÇK-së. Në opinion e krijoi një narrativë se këta janë kriminelë luftime, hajdutë të paqes dhe shkatërrues të shtetit të cilin nuk e bëri Albini e as këta yryshnikët të shitur si gazetarë, shoqëri civile apo analistë. Hakmarrjen e bëri model të qeverisjes, frikësimin si qershizë i kësaj torte qeveritare, kurse injorancën dhe nënshtrimin e përlligji, deri tek Akademia e Shkencave dhe e Arteve, në krye me një mendermethënë kryetar Akademie, me një të kaluar projugosllave dhe proudbashe. E caktoi një ekip për bisedime teknike në krye një tabula razë për bisedime politike, Besnikun ndaj Albinit, deri në shtrirje për toke. Në vend se të bëjë karrierë dhe të kontribuojë në fushën ku është profesionist, Besniku i Albinit u shndërrua në kukull shëtitëse Prishtinë - Bruksel e që më shumë i ngjante një gogoli se një kukulle. Besnikut të Albinit ia caktoi një grup këshilltarësh, disa prej tyre familjarisht dhe personalisht mercenarë të dëshmuar që "honë dhe donë" kishin qenë në shërbim të Jugosllavisë dhe të Serbisë dhe asnjëherë në shërbim të

popullit, gjuhën e të cilëve edhe e flasin, madje e konsiderojnë edhe gjuhë amtare. Pastaj, për ta trashur edhe më shumë m.j.a.n, ua punësuan edhe fëmijët në kohën kur fëmijët dhe familjarët e ushtarëve të UÇK-së, heronjve, ish-të burgosurve politikë, përndiqen apo terrorizohen duke i larguar nga puna. Sot në ministri të kësaj qeverie, ndërmarrje publike, borde keni ish-bashkëpunëtorë të Jugosllavisë dhe të Serbisë që kanë përndjekur atdhetarët shqiptarë, madje janë shumë të respektuar dhe të privilegjuar. Nga përvoja e them se çdokush që është ngritur duke keqpërdorur emrin e Bacës Adem Demaçi, pashmangshëm ka përfunduar i shtrirë për toke. Kam frikë se kjo do t'i ndodhë edhe Albin Kurtit. Do ta shohim shumë shpejt këtë, ndonëse nuk do ta dëshiroja.

Antiamerikanizmi dhe anti-evropianizmi i Albinit, pushkë e zbrazët e opozitës: Kur qeveria Kurti 1 u rrëzua me ndihmën e Grenellit, Albinit vetëm sa iu rritën votat. Opozita atëherë bëri gabim që luajti në këtë kartë të djegur. Të njëjtin gabim po e bën edhe tani! Në vend se ta sulmojë për shkak të rritjes së varfërisë të qytetarëve, korrupsionit të profilit të lartë, nepotizmit atronomik, kapjes së pamoralshme të të gjitha institucioneve, të varura apo të pavarura qofshin ato, defaktorizimin në politikë të jashtme për shkak të një ministere që këtë ministri e ka shndërruar në pornografi diplomatike, të një presidentje që urrejtjen e ka modus vivendi, të një ministri të financave që ishte deklaruar si komandant i përgjithshëm i mercenarëve dhe margaritarëve të tjerë, opozita po e akuzon Kurtin se i ka prishur raportet me amerikanët dhe me evropianët dhe këtë po ia konsideron mëkatim më të madh që e paska. Sidomos pas zhvillimeve të fundit në Veriun e Kosovës. Realisht, në aspektin ligjor dhe kushtetues, çdo kryeministër e ka për detyrim ta shtrijë sovranitetin brenda kufijve të integritetit territorial që është njohur ndërkombëtarisht. Këtë edhe e ka bërë Albin Kurti prandaj për këtë nuk duhet të sulmohet, por duhet të përkrahët. Nga të gjithë, pa përjashtim. Ose ke shtet, ose nuk ke shtet. Nuk jam përkrahës i asaj se çdo gjë që vjen nga ndërkombëtarët është e mirë dhe se duhet të pranohet pa asnjë kundërshtim. Ndërkombëtarët janë pragmatikë dhe politikanët e

vendeve të vogla i konsiderojnë si material shpenzues, material për një përdorim. Albin Kurti po del jashtë këtij stereotipi nëse do të qëndrojë deri në fund. Unë shumë dyshoj se do të qëndrojë sepse, siç thoshte Millovan Gjillasi: pushteti është pasioni më i madh i njeriut. Albin Kurti nuk ka alternativë, ose do të dorëzohet, ose do të përjashtohet. Zgjidhje të tretë nuk ka. Ndërkombëtarët i pranuan zgjedhjet lokale në katër komuna të Kosovës veriore, lavdëruan institucionet e Kosovës për organizimin e tyre, kurse tani po e përdorin si armë kundër Albinit Kurtit. Thuaja të gjithë. Kjo tregon se nuk ka miq dhe miqësi të përditshme në politikë, por se ka interes dhe vetëm interes. Interesi aktualisht po shihet te Serbia, prandaj ndërkombëtarët po e luajnë lojën që iu duhet për t'i mbrojtur këto interesa. Situata nuk është aspak e mirë, madje është shumë e keqe. Sa më shumë po kalon koha, oferta për Kosovën po varfërohet dhe lehtësisht mund të vijmë në situatë që duhet të pranojmë, jo atë që e meritojmë dhe na takon, por atë që do të na japin të fortit!

Po opozita, ç'bëri: Opozita e Kosovës, shkak i deficitit të madh në vota dhe mungesës së fuqisë politike, duroi sjelljet poshtëruese të pozitës; të gjitha propozimet e opozitës u mbivotuan, shumica e ligjeve u miratua pa pëlqimin e opozitës. Opozita nuk kishte asnjë gatishmëri dhe vullnet ta rrëzojë qeverinë Kurti 2, madje i dha përkrahje të plotë gjatë procesit të bisedimeve me Serbinë. Nga informatat që i kam, jam i sigurt se as LDK-ja e as PDK-ja nuk kishin qëllim rrëzimin e qeverisë Kurti 2 dhe nuk kishin asnjë interesim për zgjedhje të jashtëzakonshme. As për t'u bërë pjesë e koalicionit qeverisës. Opozitës nuk i konvenonin zgjedhjet e parakohshme sepse përsëri LV-ja do t'i fitonte këto zgjidhje por asses me rezultatet e mëparshme. Tash, pas ndërhyrjeve ultimative të ndërkombëtarëve kundër Albinit Kurtit, opozita u trimërua duke shpresuar se ndërkombëtarët do të votojnë për ta. Po besojnë se u krijua një mjedis më i favorshëm për ta. LDK-ja po angazhohet për një rrugë të tretë duke u përcaktuar për takime me personalitete me ndikim, media dhe shoqëri civile. pordhë e ftohtë është kjo, nuk ka asnjë lidhje me një aktivizëm opozitar. E vetmja risi është mospjesëmarrja në punët e Kryesisë së Kuvendit që, nëse

përcillen nga partitë tjera do ta sjellë paralizimin e punës së Kuvendit të Kosovës, edhe ashtu të falimentuar, më shumë nga pozita se nga opozita. PDK-ja doli me një Dekalog prej 10 pikëve që është një opozitarizëm më aktiv se i LDK-së. Jo se Albin Kurti dhe Vojsa Osmani fort mërziten pse PDK-ja nuk i takon deri në një vendim tjetër por se, nëse do të jenë konsekuent në qëndrime puna e mexhllisit të Glauk bin Sherifit do të ikën për lesh dhe zgjedhjet janë të pashmangshme. PDK-ja nuk ka pasur tjetër mundësi reagimi madje edhe ky reagim është shumë i butë, është dashur të reagohej më herët. Në emër të reformimit dhe shkaku i nokautit të pësuar në zgjedhjet e fundit parlamentare, opozitarizmi u ngufatë. Rezultatet e zgjedhjeve lokale ishin një infuzion domethënës për ringjallje të opozitarizmit, por se kjo nuk ndodhi e që për mua nuk ka asnjë kuptim. Jam i sigurt se sot, as LDK-ja e as PDK-ja vullnetarisht nuk do të pranoni të bëhen pozitë por se, më shumë po e përdorin si mënyrë për ta shtyrë Albinit Kurtin të veprojë në përputhje me kërkesat e ndërkombëtarëve. Sa më shumë t'i bëhet presion Albinit Kurtit nga ndërkombëtarët dhe vendorët të bëjë lëshime politike, aq më shumë do të dobësohet pozita e Kosovës. Sa më shumë që Albin Kurti, në vend të një racionalizimi të mundësive ekzistuese për veprim, ta përdorë ndjenjën e madhështisë për t'u kurorëzuar si baba i Kombit, Qosja tashmë është babagjysh i Kombit, hendeuku do të thellohet duke u shndërruar në një greminë ku do të përfundojmë të gjithë. Nëse Albin Kurti do të veprojë në përputhje me mundësitë që i ka Kosova, do ta ketë edhe përkrahjen e opozitës dhe të tjerëve, në të kundërtën ikëm për lesh. Për rrethana aktuale është një zgjidhje e ndërmjetme që besoj se do ta pranojë edhe Albin Kurti. Presidentja e Kurtit paralajmëroi se do të tejkalohej ngërçi me ndërkombëtarët dhe i besoj kësaj. Albini është prapa këtyre fjalëve prandaj edhe e thirrën Lajçakun, serbo-slovakun fluturues që sot erdhi në Kosovë. Në situatën që jemi pushteti nuk i duhet asgjë, as pozitës e as opozitës prandaj të gjithë duhet të përbashkohen të shpëtohet çka mund të shpëtohet. Kosovës i duhet një lider që merr vendime të rënda, jo për të fituar çdo gjë sepse kjo mundësi ka ikën me erën por që humbjet t'i bëjë sa më të vogla dhe sa më të përbalueshme. Asgjë tjetër. Të tjerat janë përralla!

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT
 PILKINGTON
 Envert
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Cana: Në Romë ende ma kujtojnë Kupën e Italisë

TIRANË, 4 KORRIK - Lorik Cana pa dyshim do të mbahet mend gjatë kur bie fjala për historinë e Kombëtares shqiptare. Me mbi 90 lojë në përfaqësuese, kapiteni që udhëhoqi ekipin në suksesin e "Euro 2016" rikthehet mbrapa në kohë dhe kujton fillimet e tij, kalimin nga PSG-ja te rivalët e Marseilles, përvojën në Premierë Ligë dhe prapaskenat me Benitesin dhe Arsen Wengerin, si dhe suksesin e paharrueshëm me Lazion në Itali, duke folur në një intervistë për "Worldfootballindex".

Lorik, keni filluar karrierën si profesionist te PSG-ja. Si ka qenë ajo përvojë me klubin?

Cana: Ishte një përvojë e mirë për mua, sepse fëmijëria ime u nda mes Kosovës dhe Zvicrës, ku fillova të luaj futboll me Lausan Sport dhe aty u pashë nga PSG-ja në moshën 16-vjeçare. Gjeta mundësinë për të shkuar atje në provë, shkoi mirë dhe klubi nënshkroi me mua. Të qenit pjesë e një klubi kaq të madh në moshë të re më mundësoi të stërvitem dhe të mësoj nga lojtarë si Ronaldinho, Anelka, Gabriel Heinze, Okocha dhe shumë të tjerë. E dija se të kesh lojtarë si ata që kam përmendur, lojtarë të formuar të ekipit të parë, do të thoshte se do të ishte e vështirë për një lojtar të akademisë si unë të futej në ekipin e parë. E vështirë, por pse jo e pamundur. Isha i vendosur t'ia dalë dhe, fatmirësisht, ia arrita. Jam krenar për këtë pjesë.

Ju fituat Kupën e Francës me PSG-në në vitin 2004. Sa e veçantë ishte arritja e një suksesi të tillë?

Cana: Ishte fantastike për mua të luaja për ekipin e parë dhe të fitoja një trofe, ishte një ëndërr e realizuar. Kam bërë debutimin tim me Ronaldinhon një vit para finales në 2004-n dhe të luaja përkrah tij ishte një emocion i madh për mua. Ai ishte një futbollist i jashtëzakonshëm. Gjatë vitit të suksessit të Kupës, unë luaja rregullisht në ekipin e parë, gjë që ishte e mahnitshme për mua, sepse jo shumë lojtarë fitojnë një

trofe në vitin e tyre të parë si profesionist.

Më pas kaluat nga PSG-ja te rivalët e Marseilles në 2005-n. A hapi ky veprim shumë diskutime në atë kohë?

Cana: Historia pas lëvizjes ishte e thjeshtë. Kisha luajtur në Ligën e Kampioneve dhe fitova Kupën me PSG-në, por si produkt i akademisë, kurrë nuk e ndjeva se do të shihesha si zgjedhja e parë për ekipin A, sepse isha ende një lojtar i ri. Përveç kësaj, unë isha një tifoz i Marseillës që nga koha ime në Zvicër në fillim të viteve '90-të, ndërsa i shikoja ata të ngrinin Kupën Evropiane në 1992-shin. Marseille është e vetmja skuadër franceze për të cilën do të isha larguar nga PSG-ja dhe si lojtar i ri, ishte një lëvizje që solli sfida me rivalitetin e të dy klubeve, por nuk jam penduar që kalova atje.

Bëheni kapiten i Marseilles, arrini dy finale dhe luani në Ligën e Kampioneve. Si do ta përmbledhni kohën tuaj në këtë klub?

Cana: Më pëlqeu koha në klub dhe ishte një periudhë e suksesshme. Ne nuk ishim rregullisht në Ligën e Kampioneve, kur erdha pranë lojtarëve si Frank Ribery, Mamadu Niang dhe të tjerë. Megjithatë, ky grup me ata lojtarë dukej se e ndihmoi shumë skuadrën, pasi ne vazhduam të vendoseshim si një klub i Ligës së Kampioneve, duke përfunduar në tri të parat e ligës franceze gjatë kohës sime në klub. Arritja e dy finaleve të kupave me klubin ishte e veçantë, megjithatë humbja e një rasti të tillë nuk është kurrë e këndshme për një lojtar. E vetmja keqardhje që kam nga koha ime në klub ishte sezoni im i fundit kur përfundam në vendin e dytë në kampionat dhe Bordo u shpall kampion. Ndjeva se ai sezon ishte një mundësi e humbur për ne që të fitonim titullin pasi kishim një ekip të fortë dhe luajtëm mirë në sezon, por Bordo arriti të fitonte njëmbëdhjetë ndeshjet e tyre të fundit, gjë që ishte jetike për suksesin e tyre. Pavarësisht kësaj, kam kujtime të



shkëlqyera nga koha ime në klub. Tifozët ishin të mrekullueshëm me mua dhe unë arrita një ëndërr fëmijërie për të përfaqësuar Marseillen dhe më pëlqeu çdo mundësi që më duhej të dilja në stadium si lojtar i saj.

Ju u transferuat te Sanderlandi në Premierë Ligë nga Marseille në vitin 2009. Si ndodhi kjo lëvizje?

Cana: Për të qenë i sinqertë, në verën e vitit 2009, e dija që do të largohesha nga Marseille, pasi kishte një sërë ndryshimesh në klub, me të cilat nuk isha i kënaqur. Para se të shkoja në Sanderland, në fakt mendova se do të nënshkruaja për Hamburgun në Bundesligë. Klubet ranë dakord dhe me mua, por Hamburgu tërhoqi prizën në minutën e fundit, jo vetëm me mua, por edhe me lojtarë të tjerë që ata kishin në plan të nënshkruanin, pa asnjë arsye. Pas kësaj lëvizje, unë kisha opsione të tjera në Bundesligë ose të luaja në Premier Ligë me Sanderlandin. Në të kaluarën, unë kam qenë i lidhur me Liverpoolin kur Rafa Benites ishte trajner, kam pasur disa kontakte me Arsen Wengerin kur ai ishte tek Arsenali dhe David Moyes kur ai ishte në Everton. Megjithatë, Stiv Brusin dhe Sanderland u përpoqën shumë për të nënshkruar me mua dhe unë vendosa të bashkohem me ta. Të luaja në Angli ishte diçka që gjithmonë doja ta bëja kur erdhi mundësia për të luajtur në Premier Ligë, e mora atë dhe bëra lëvizjen, veçanërisht pasi fola me Stiv Brusin. Ai më bëri vërtet përshtypje me mënyrën dhe qasjen e tij kur e takova përpara se të nënshkruaja. Më pëlqeu pasioni i tij për futbollin dhe e lashë takimin me të duke e ditur se doja të luaja për të.

Si ishte përvoja juaj në Premierë Ligë në krahasim me kohën në futbollin francez?

Cana: Premierë Liga është liga më e mirë në botë, me futbollin më të mirë në botë. E di që thuhet shumë, por të gjithë në Angli jetojnë dhe marrin frymë me futbollin. E ndjeva menjëherë. Stadiumet ishin fantastike dhe tifozët e ndiqnin lojën nga fillimi në fund duke brohoritur për diçka kaq të thjeshtë si një ndërhyrje në mesfushë. Sa herë që më duhej të hyja në një duel, ishte sikur turma po e bënte atë me mua dhe nuk e kisha përjetuar shumë shpesh në të kaluarën. Sanderlandi si klub ishte pikërisht ashtu siç e prisja pasi fola me Stiv Brusin dhe ne patëm një sezon të mirë, duke përfunduar në vendin e 13-të në tabelë. Fatkeqësisht, pësova një dëmtim të keq në ijë në Krishtlindje, gjë që më ndikoi fizikisht në gjysmën e dytë të atij sezoni. Përfundova duke u larguar nga klubi në fund të atij sezoni, por nuk kam asgjë tjetër veçse kujtime të mira nga Sanderlandi dhe tifozët. Ata janë tifozë të jashtëzakonshëm dhe njerëz që e duan shumë klubin e tyre.

Pas një sezoni në Angli, ju u transferuat në Turqi me Galatasarayn, ku luajtët nën drejtimin e Frenk Rajkardit... Përse zgjodhët Turqinë?

Cana: Pas sezonit tim në Sanderland, u ndjeva mirë dhe doja të kaloja në një klub më të madh. Në fund, Galatasaray bëri një lëvizje për mua. Ata janë një klub gjigant. U themeluan nga një shqiptar, kështu që unë kisha një lidhje me klubin në një mënyrë që më tërhoqi drejt kësaj lëvizjeje. Ndihej si një mundësi shumë e mirë për ta refuzuar. Ishte një

kohë sfiduese kur erdha në Turqi, sepse klubi nuk u kualifikua për në Evropë dhe situata financiare u ndikua nga kjo. Gjërat nuk shkuan aq mirë as në ligë për ne, pasi përfundam në vendin e 8-të, gjë që më bëri të dëshiroja të kthehesha në "top" pesë ligat evropiane, të cilën pata mundësinë ta bëja me Lazion.

Me Lazion keni kujtime të bukura, pasi keni fituar një Kupë të Italisë kundër rivalëve të Romës. Çfarë kujtoni nga ajo kohë?

Cana: Ishte një nga momentet më të mira të karrierës sime. Pa dyshim. Tifozët nuk donin asgjë më shumë se të mposhtnin Romën dhe duke e mposhtur në finalen e Kupës së Italisë falë golit të Senad Luliçit, ne u bëmë legjenda të gjalla në sytë e tifozëve. Ishte finalja e parë e Kupës mes Lazios dhe Romës, që e bëri edhe më të ëmbël fitoren tonë. Ishte një moment historik dhe kaq i rëndësishëm për të gjithë në klub. Unë jetoj ende sot në Romë dhe nuk kalon asnjë ditë pa më kujtuar dikush finalen e 2013-ës dhe suksesin që arritëm.

Keni mbi 90 ndeshje me Shqipërinë dhe keni mbajtur edhe shiritin e kapitenit. Sa rëndësi kanë ato paraqitje për ju dhe familjen tuaj?

Cana: Që i vogël, ëndërroja të luaja për Shqipërinë. Ekipi kombëtar u bë simbol i kombit tonë dhe të përfaqësoja flamurin do të thoshte shumë për mua. Unë isha pjesë e ekipit kur u kualifikuam për turneun tonë të parë të madh, që ishte "Euro 2016" dhe kjo ishte një arritje përtej imagjinatës sime. Arritja e një suksesi historik, si ai me vendin tim, ishte suksesi më i madh i karrierës sime.



Gliha, trajner i Kosovës

PRISHTINË, 4 KORRIK - Primozh Gliha është emëruar të martën edhe zyrtarisht trajner i Përfaqësueses së Kosovës në futboll. Në fakt, Komiteti Ekzekutiv i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) ka

mbajtur mbledhjen e radhës ku u vendos që Gliha të jetë pasardhës i Giresses. “KE i FFK-së vendosi që në krye të shtabit teknik të emërohet Primozh Gliha, derisa atij do t’i ndihmojnë Afrim Tovërlani,

Arbnor Morina, Ahmet Beselica dhe Thomas Richards. KE i FFK-së ka vendosur t’ua besojë drejtimin e ‘Dardanëve’ ekipit të brendshëm të trajnerëve që tashmë janë të angazhuar në ekipet

kombëtare. Ata njëherësh do të qëndrojnë në ekipet e grupmoshave që i drejtojnë, por do të jenë të angazhuar për ta ndihmuar përzgjedhësin Gliha në Përfaqësuesen A”, thuhet në njoftimin e FFK-së.



Saraçini: Evropiani është nivel tjetër, jemi gati

Prishtinë, 4 korrik - Kryetari i Federatës së Hendbollit të Kosovës, Eugen Saraçini, në një konferencë për medie foli lidhur me Kampionatin Evropian për hendbollistët deri në 19 vjet që fillon të shtunën në Prishtinë. Saraçini në konferencë ishte i shoqëruar nga Edi Kolgeci, anëtar i Bordit të FHK-së. Saraçini ka thënë se kjo ngjarje është e nivelit më të lartë të organizuar deri më tani në sportet ekipore, ndërsa është kërkuar angazhim i madh i të gjithë të përfshirëve. Ai ka thënë se të gjitha përgatitjet janë bërë dhe se Federata e Hendbollit e Kosovës është e gatshme që sërish të dëshmojë si nikoqire shembullore. “Siç dihet, këtë kampionat po e organizojmë ne saxe të bashkëpunimit të jashtëzakonshëm që e kemi me Federatën Evropiane të Hendbollit. Vitin e kaluar kemi biseduar që ne ta organizojmë këtë kampionat, që është miratuar, dhe krejt kjo falë përvijës sonë të deritashme, respektivisht organizimeve që FHK-ja i ka bërë në nivel botëror dhe evropian të kampionateve të ndryshme në të dyja konkurrencat. Mund të them se përgatitjet kanë qenë mjaft komplekse dhe e gjithë zyra e federatës dhe vullnetarët kanë bërë një punë të shkëlqyer deri më tash, duke filluar nga vendosja, saktësisht përgatitja e hoteleve për pjesëmarrësit, organizimi i transportit si dhe të gjitha kushtet që kanë të bëjnë edhe me palestrat ku do të zhvillohen ndeshjet”, ka thënë Saraçini, i cili bëri me dije se shtetet pjesëmarrëse janë Sllovakia, Italia, Finlanda, Kosova dhe Britania



e Madhe që janë në Grupin A, ndërsa Grupi B përbëhet nga Polonia, Letonia, Austria e Izraeli. Pra, gjithsej 9 ekipe evropiane do të marrin pjesë në këtë kampionat. Numri një i FHK-së konfirmoi se të gjitha ekipet kanë konfirmuar ardhjen dhe pas dy ditëve do ta fillojnë arritjen në Prishtinë. “Partneri kryesor i kësaj ngjarjeje, që ka kontribuar në këtë organizim, është MKRS-ja, ku me këtë rast falënderoj ministrin Çeku dhe zëvendësimin Osmanin. Pastaj partner në këtë ngjarje është edhe Federata Evropiane, KOK-u, por edhe të tjerë që kanë obligime dhe detyrime që i kanë marrë në kuadër të këtij organizimi, si policia, dogana, sigurimi, ekipet mjekësore. Është, siç thashë, një organizim mjaft kompleks, një nivel i ri i organizimit në kuadër të sporteve ekipore në Kosovë, ndoshta i vetmi deri më tani që është në nivel kaq të lartë dhe mendojmë që me të gjitha organizimet që i kemi bërë deri më tani dhe përvijën që e kemi, mendojmë se edhe kësaj radhe të

kemi rezultate pozitive”, ka shtuar ai. “Dua të bëj një ftesë për qytetarët e Prishtinës, por edhe gjithë Kosovës, në veçanti fansat e hendbollit, përfshirë lojtarët dhe lojtarët e klubeve, që këto ditë të kampionatit të jenë në palestër dhe t’i shikojnë ndeshjet që kanë një nivel më të lartë se që kemi pasur mundësi të kemi deri më tani në kryeqytet. Ekipi i Kosovës është në përgatitje e sipër dhe mendojmë se, pavarësisht prej cilësisë së ekipeve pjesëmarrëse, edhe Kosova do të jetë një ekip që do të garoj me dinjitet në këtë kampionat. Hyrja do të jetë falas, ndërsa palestra ku do të luhen ndeshjet është totalisht e ridizajnuar dhe do të jetë e kompletuar prej ditës së parë për të gjithë ata që duan t’i shikojnë ato”, ka deklaruar Saraçini. Më 8 korrik bëhet hapja zyrtare e kampionatit rreth orës 18:30, para ndeshjes në mes të Kosovës dhe Sllovakisë. Saraçini shpreson që zyrtarët më të lartë të Republikës së Kosovës të marrin pjesë, pasi do të bëhet një ambient i bukur për të gjithë.

SHKURT

Trajneri i Kosovës: Krenar që drejtoj Kosovën, do ta japim maksimumin

Përzgjedhësi i ri i Kosovës në basketboll, Rami Hadar, ka thënë se do të mundohet ta bëjë një ekip kompakt, i cili do të mund t’u bëjë ballë kundërshtarëve. Ai ndihet i lumtur dhe i privilegjuar që iu besua kjo pozitë. “Jam i lumtur që jam këtu. Jam krenar që drejtoj Kosovën. Jam krenar që Federata e Basketbollit më zgjodhi mua për ta drejtuar këtë ekip. Lojtarët erdhën me disponim të mirë dhe me harmoni. I kemi bërë vetëm tri stërvitje dhe është ende herët të themi diçka për basketbollin. Më pëlqen qëndrimi i tyre dhe shpresoj ta bëjmë një lojë të bukur”, ka thënë Hadar për faqen zyrtare të FBK-së. Ai foli edhe për kundërshtarët e Kosovës në rrethin e tretë parakualifikues të Eurobasket 2025, respektivisht Zvicrën dhe Danimarkën. “Mendoj se përpara nesh janë dy ekipe të mira, me lojtarë të mirë dhe të njohur. Por, ne duhet të garojmë, ta bëjmë punën tonë dhe puna ime është t’i fitoj ndeshjet me Kosovën. Dua ta dërgoj ekipin te përpjekja maksimale, që lojtarët të luajnë për njëri-tjetrin dhe që të luajnë për flamurin”, ka deklaruar Hadar.

Elshani, përforcimi i radhës nga FC Suhareka

FC Suhareka ka njoftuar se ka arritur marrëveshje me njërin ndër mesfushorët më kualitativ të futbollit kosovar, Qemajl Elshani. Elshani edicionin e fundit pati një sezon fantastik në Prizren te KF Liria, ku arriti inkuadrimit në Superligë, duke ndihmuar klubin me gola dhe shumë asistime. “Qema’ ndryshe është kampion i Kosovës me skuadrën e KF Feronikeli, duke i fituar të gjitha trofetë e mundshëm me skuadrën nga Drenasi dhe, gjithashtu, fitues të kupës me skuadrën e KF Besa e FC Prishtinën. Ai gjithashtu ka mbrojtur ngjyrat edhe te KF Drenica, KF Drenasi etj. Me ardhjen e Qemajlit mesfusha jonë bëhet edhe më e fortë duke shpresuar që të bashkuar mund t’i arrijmë sukseset e radhës”, thuhet në njoftimin e FC Suhareka.

Khaka, shumë afër kalimit në Leverkusen

Mesfushori shqiptar Granit Khaka është gjithnjë e më afër largimit nga Arsenal, sipas “Football.London”. Mediumi në fjalë raporton se kapiteni i Kombëtares së Zvicrës është afër transferimit te Bayer Leverkuseni për një shumë prej 24 milionë eurosh. Për Khakën Bundesliga nuk është vend i panjohur, pasi para transferimit në Arsenal ka luajtur me plot sukses te Borussia Monchengladbachu.

Tottenhami refuzon ofertën e parë të Bayernit për Kane

Bayern Muchen ofroi 60 milionë paund për sulmuesin Harry Kane, por kjo ofertë është refuzuar nga Tottenham Hotspuri. “Spurs” kërkon 114 milionë për sulmuesin që vitin tjetër i përfundon kontrata. Oferta e dytë e Bayernit pritet të jetë 80 milionë paund, plus bonuse, një ofertë e cila pritet ta “zbusë” skuadrën angleze që të heqë dorë nga Kane.

Krasniqi: Bëhuni gati për duelin e shekullit në trojet shqiptare

Prishtinë, 4 korrik - Boksieri nga Kosova, Robin ‘Haxhi’ Krasniqi, ka bërë thirrje të blihen biletat në numër sa më të madh për luftën e radhës që ai do ta zhvillojë më 5 gusht në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë. Para dy muajve Krasniqi njoftoi për meçin e tij ndaj Nadjib Mohammedi, të cilin e ka cilësuar si “dueli i shekullit”. Tani boksieri me renome botërore ka bërë thirrje për blerjen e biletave pasi synon numër sa më të madh të mbështetësve në stadiumin



“Fadil Vokrri”. Është vetë Krasniqi i cili thirrje ka bërë me një shkrim në

“Facebook”. “Robin Krasniqi vs. Nadjib Mohammedi: ky do të jetë dueli i shekullit në trojet shqiptare. Asnjëherë më parë në Kosovë, Shqipëri apo kudo në trojet shqiptare, duel më të madh nuk kemi pasur, andaj siguroni biletat tuaja që tani për këtë luftë të zjarrtë që do të zhvillohet më 5 gusht 2023 në stadiumin ‘Fadil Vokrri’. Kjo luftë 12 randshe është e vlefshme për titullin WBC SILVER në kategorinë gjysmë të rëndë!”, ka shkruar Krasniqi.

Inter Miami synon edhe transferimin e Ramosit

Skuadra e Inter Miamit duket se nuk ka të ndalur në këtë merkato, teksa pas Messit dhe Busquets, synon

një tjetër lojtar të madh. Sipas raportimeve më të fundit nga mediet britanike, pronari i Inter

Miamit, David Beckham, kërkon të sjellë në Majemi edhe kampionin e Botës e të Evropës me Spanjën,

Sergio Ramos. Qendërmbrojtësi spanjoll, tashmë 37-vjeçar, ka mbetur pa ekip, që prej të

premtes së 30 qershorit, pasi përfundoi kontratën e tij me gjigantët francezë të Paris Saint-Germainit.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

KRYETARI I KOMUNËS

INr.464/01-57437
Datë: 22.06.2023

Në bazë të dispozitave të neneve 11, 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 datë 4 Qershor 2008, nenit 4 dhe nenit 11 të Ligji Nr.03/L-139 Për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.52/08 Maj 2009 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.91/10 Dhjetor 2010, dispozitave të nenit 83 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 datë 25 Maj 2016, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/21 Qershor 2016, nenit 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës së Lipjanit merr:

VENDIM PËRFUNDIMTAR

I. MIRATOHET shpronësimi i pronave të paluajtshme, për arritjen e qëllimit dhe përfitimit të ligjshëm publik për ndërtimin e segmenteve rrugore "Bashkim Krasniqi" në Lipjan, të Njesisë kadastrale P-71409044-01857-1 me sipërfaqe prej 160m² në Zonën Kadastrale Lipjan në emër të Nebojshta Andrijevic (Dragisha) nga Lipjani.

II. Pjesë e këtij Vendimi është Akti i Vlerësimit në të cilin është përcaktuar shuma e kompensimit për ata Pronar apo Zotërues të Interesit, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të të cilëve janë prekur nga procesi i shpronësimit.

III. Nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, obligohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa, që brenda afatit prej dy (2) viteve të paguaj plotësisht shumën e kompensimit të pronës së shpronësuar të përcaktuar sipas raportit të vlerësimit të Zyrës për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave, Departamenti i Tatimit në Pronë të Republikës së Kosovës të datës 12.06.2023.

IV. Kundër këtij Vendimi brenda tridhjetë (30) ditëve kalendrike pas hyrjes në fuqi të tij, kanë të drejtë të paraqesin ankesë në Gjykatën Themelore Prishtinë-dega në Lipjan çdo person i cili është Pronar ose Zotërues i Ineresit në pronën ose të drejtat pronësore të prekura nga Vendimi Përfundimtar, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në vendim, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit në përputhje me nenet 36 dhe 37 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin Nr.03/L-205 datë.28 Tetor 2010 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.91).

V. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit-Sektorit Pronësoro-Juridik, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Drejtorati për Infrastrukturë.

VI. Ky vendim paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtorati për gjeodezi dhe Kadastër është i obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.

VII. Vendimi Përfundimtar hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe publikimit të tij në një tërësi nga gazetat me tirazh më të madh në Kosovë.

Vendimi i'u dërgohet:

- Nebojshta Andrijevic (Dragisha)
- Drejtorati për Urbanizëm Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Drejtorati për Buxhet dhe Financa
- Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër
- Drejtorati për Infrastrukturë
- Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim
- Arkiviti të Komunës

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

PRESDENNIK OPŠTINE

1Br.464/01-57437
Datum:22.06.2023

Na osnovi stavova člana 11,13 Zakona o Lokalnoj Samoupravi br.03/L-040, Službene Novine Republike Kosova, Br. 28 dt 4 Juni 2008, člana 4 i člana 11 zakona Br.03/L-139 za eksproprijaciju nepokretne imovine, Službene Novine Republike Kosova, Br.52/08 Maj 2009 sa promenama i dopunama obavljene sa Zakonom Br.03/I-205, Službene Novine Republike Kosova, Br. Nr.91/10 Decembar 2010, stavova člana 83 Zakona za Opštu Administrativno Proceduri Br.05/L-031 Službene Novine Republike Kosova, Br.20/21 Juni 2016, član 40 i 41 Statuta Opštine Lipljan 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Predsednik Opštine Lipljan donosi:

ZAVRŠNU ODLUKU

I. USVAJA SE eksproprijacija nepokretne imovine, za ostvarivanje cilje i pravne javne koristi za izgradnju segmenata puta „Bashkim Krasniqi“ u Lipljanu, katastarske jedinice P-71409044-01857-1 površine 160m² u s. Katastarska zona Lipljan na ime Nebojshta Andrijevic (Dragisha) iz Lipjana.

II. De ove Odluke akat procenjivanja u kojem je određen iznos kompenziranja za one vlasnike ili imalaca interesa, pravo vlasništva ili zakonskih interesa kojima je dotaknulo imanje u procesu eksproprijacije.

III. Od dana stupanja na snazi ove Odluke, obavezuje se Direktorat za Budžet i Financije, da u roku od dve (2) godine isplati u celini iznos kompezacije ekspropriisane imanje određene prema izveštaju procenjivanja Kancelarije Procenjivanja Nepokretne Imanja u okviru Ministarstva Financije- Departament za Poreza na Imovino Republike Kosova dt.12.06.2023.

IV. Protiv ove Odluke unutar trideset (30) kalendarskih dana nakon stupanja na snazi, imaju pravo da podnesu žalbu u Osnovni Sud Priština-ogranak Lipljan svako lice je vlasnik ili vlasnik interesa ili pravo vlasništvo dodatnute, kao svako zainteresiovano lice ima neki direktan materialni interes u nepokretnu imovinu, nezavisno ako nije identifikovan ili ne u Odluci ,za protivljenju iznos kompenzacije u skaldu sa članom 36 i 37 Zakona Br.03/L-139 za Eksproprijaciju Nepokretne Imovine sa dopunama i promenama Zakona Br.03/I-205 dt.28 Oktobar 2010 (Službene Novine Republike Kosova Br.91).

V. Za sprovođenje ove Odluke obavezuje se kancelarija Predsednika-Pravno Imovinski Sektor, Direktorat Planiranje, Urbanizma i Zaštite Sredine, Direktorat za Budžet i Financije, Direktorat Geodezije i Katastar, Direktorat javnih Usluga. Zaštitei Ispašavanje i Direktorat za Infrastrukturu.

VI. Ova Odluka predstavlja pravni osnov za upisivanje u katastarskim knjigama na ime novih vlasnika tehničke podele katastarskoih parcela.Sa staupanjem na snazi ove Odluke, Direktorat za Geodeziju i Katastar je obavezan da obavlja proceduralne i tehničke postupke za njegovo sprovođenje.

VII.Završna Odluka stupa na snazi dana objavljivanja u Službene Novine Republike Kosova i objavljivanju u neku novinu sa većim tiražom na Kosovo.

Odluka dostaviti:

- Nebojshta Andrijevic (Dragisha)
- Direktoratu Planiranja Urbanizma i Zaštite Sredine
- Direktoratu za Budžet i Financije
- Direktoratu Geodezije i Katastra
- Direktorat za Infrastrukturu
- Direktoratu Javnih Usluga, Zaštitei Ispašavanje
- Arhivi Opštine

PRESDENNIK OPŠTINE

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

INr.464/01-57437
Datë: 22.06.2023

Në bazë të dispozitave të neneve 11, 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 datë 4 Qershor 2008, nenit 4 dhe nenit 11 të Ligji Nr.03/L-139 Për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.52/08 Maj 2009 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.91/10 Dhjetor 2010, dispozitave të nenit 83 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 datë 25 Maj 2016, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/21 Qershor 2016, nenit 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës së Lipjanit merr:

VENDIM PËRFUNDIMTAR

I. MIRATOHET shpronësimi i pronave të paluajtshme, për arritjen e qëllimit dhe përfitimt të ligjshëm publik për ndërtimin e segmenteve rrugore "Bashkim Krasniqi" në Lipjan, të Njësisë kadastrale P-71409044-01857-2 me sipërfaqe prej 182m² në Zonën Kadastrale Lipjan në emër të Lubisha Andrejeviq (S) nga Lipjani.

II. Pjesë e këtij Vendimi është Akti i Vlerësimit në të cilin është përcaktuar shuma e kompensimit për ata Pronar apo Zotërues të Interesit, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të të cilëve janë prekur nga procesi i shpronësimit.

III. Nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, obligohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa, që brenda afatit prej dy (2) viteve të paguaj plotësisht shumën e kompensimit të pronës së shpronësuar të përcaktuar sipas raportit të vlerësimit të Zyrës për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave, Departamenti i Tatimit në Pronë të Republikës së Kosovës të datës 12.06.2023.

IV. Kundër këtij Vendimi brenda tridhjetë (30) ditëve kalendrike pas hyrjes në fuqi të tij, kanë të drejtë të paraqesin ankesë në Gjykatën Themelore Prishtinë-dega në Lipjan çdo person i cili është Pronar ose Zotërues i Inerestit në pronën ose të drejtat pronësore të prekura nga Vendimi Përfundimtar, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në vendim, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit në përputhje me nenet 36 dhe 37 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin Nr.03/1-205 datë.28 Tetor 2010 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.91).

V. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit-Sektorit Pronësoro-Juridik, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Drejtorati për Infrastrukturë.

VI. Ky vendim paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtorati për gjeodezi dhe Kadastër është i obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.

VII. Vendimi Përfundimtar hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe publikimit të tij në njëri nga gazetat me tirazh më të madh në Kosovë.

Vendimi i'u dërgohet:

- Lubisha Andrejeviq (S)
- Drejtorati për Urbanizëm Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Drejtorati për Buxhet dhe Financa
- Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër
- Drejtorati për Infrastrukturë
- Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim
- Arkivit të Komunës

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

PRESDENNIK OPŠTINE

1Br.464/01-57437
Datum:22.06.2023

Na osnovi stavova člana 11,13 Zakona o Lokalnoj Samoupravi br.03/L-040, Službene Novine Republike Kosova, Br. 28 dt 4 Juni 2008, člana 4 i člana 11 zakona Br.03/L-139 za eksproprijaciju nepokretne imovine, Službene Novine Republike Kosova, Br.52/08 Maj 2009 sa promenama i dopunama obavljene sa Zakonom Br.03/1-205, Službene Novine Republike Kosova, Br. Nr.91/10 Decembar 2010, stavova člana 83 Zakona za Opštu Administrativno Proceduri Br.05/L-031 Službene Novine Republike Kosova, Br.20/21 Juni 2016, član 40 i 41 Statuta Opštine Lipljan 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Predsednik Opštine Lipljan donosi:

ZAVRŠNU ODLUKU

I. USVAJA SE eksproprijacija nepokretne imovine, za ostvarivanje cilje i pravne javne koristi za izgradnju segmenata puta „Bashkim Krasniqi“ u Lipljanu, katastarske jedinice P-71409044-01857-2 površine 182m² u s. Katastarska zona Lipljan na ime Lubisha Andrejeviq (S) iz Lipjlana.

II. De ove Odluke akat procenjivanja u kojem je određen iznos kompenziranja za one vlasnike ili imalaca interesa, pravo vlasništva ili zakonskih interesa kojima je dotaknulo imanje u procesu eksproprijacije.

III. Od dana stupanja na snazi ove Odluke, obavezuje se Direktorat za Budžet i Financije, da u roku od dve (2) godine isplati u celini iznos kompezacije ekspropriisane imanje određene prema izveštaju procenjivanja Kancelarije Procenjivanja Nepokretne Imanja u okviru Ministarstva Financije- Departament za Poreza na Imovino Republike Kosova dt.12.06.2023.

IV. Protiv ove Odluke unutar trideset (30) kalendarskih dana nakon stupanja na snazi, imaju pravo da podnesu žalbu u Osnovni Sud Priština-ogranak Lipljan svako lice je vlasnik ili vlasnik interesa ili pravo vlasništvo dodatnute, kao svako zainteresiovano lice ima neki direktan materialni interes u nepokretnu imovinu, nezavisno ako nije identifikovan ili ne u Odluci ,za protivljenju iznos kompenzacije u skaldnu sa članom 36 i 37 Zakona Br.03/L-139 za Eksproprijaciju Nepokretne Imovine sa dopunama i promenama Zakona Br.03/1-205 dt.28 Oktobar 2010 (Službene Novine Republike Kosova Br.91).

V. Za sprovođenje ove Odluke obavezuje se kancelarija Predsednika-Pravno Imovinski Sektor, Direktorat Planiranja, Urbanizma i Zaštite Sredine, Direktorat za Budžet i Financije, Direktorat Geodezije i Katastar, Direktorat javnih Usluga, Zaštitei Ispašavanje i Direktorat za Infrastrukturu.

VI. Ova Odluka predstavlja pravni osnov za upisivanje u katastarskim knjigama na ime novih vlasnika tehničke podele katastarskoih parcela.Sa staupanjem na snazi ove Odluke, Direktorat za Geodeziju i Katastar je obavezan da obavlja proceduralne i tehničke postupke za njegovo sprovođenje.

VII. Završna Odluka stupa na snazi dana objavljivanja u Službene Novine Republike Kosova i objavljivanju u neku novinu sa većim tiražom na Kosovo.

Odluka dostaviti:

- Lubisha Andrejeviq (S)
- Direktoratu Planiranja Urbanizma i Zaštite Sredine
- Direktoratu za Budžet i Financije
- Direktoratu Geodezije i Katastra
- Direktorat za Infrastrukturu
- Direktoratu Javnih Usluga, Zaštitei Ispašavanje
- Arhivi Opštine

PRESDENNIK OPŠTINE

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

INr.464/01-57437
Datë: 22.06.2023

Në bazë të dispozitave të neneve 11, 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 datë 4 Qershor 2008, nenit 4 dhe nenit 11 të Ligji Nr.03/L-139 Për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.52/08 Maj 2009 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.91/10 Dhjetor 2010, dispozitave të nenit 83 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 datë 25 Maj 2016, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/21 Qershor 2016, nenit 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës së Lipjanit merr:

VENDIM PËRFUNDIMTAR

I. MIRATOHET shpronësimi i pronave të paluajtshme, për arritjen e qëllimit dhe përfitimit të ligjshëm publik për ndërtimin e segmenteve rrugore "Bashkim Krasniqi" në Lipjan, të Njësisë kadastrale P-71409044-01879-1 me sipërfaqe prej 201m² në Zonën Kadastrale Lipjan në emër të Novica Jorgiq (Stojadin), Milena Laziq (Stojadin) dhe Zorica Daniqiq (Stojadin) nga Lipjani.

II. Pjesë e këtij Vendimi është Akti i Vlerësimit në të cilin është përcaktuar shuma e kompensimit për ata Pronar apo Zotërues të Interesit, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të të cilëve janë prekur nga procesi i shpronësimit.

III. Nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, obligohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa, që brenda afatit prej dy (2) viteve të paguaj plotësisht shumën e kompensimit të pronës së shpronësuar të përcaktuar sipas raportit të vlerësimit të Zyrës për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave, Departamenti i Tatimit në Pronë të Republikës së Kosovës të datës 12.06.2023.

IV. Kundër këtij Vendimi brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas hyrjes në fuqi të tij, kanë të drejtë të paraqesin ankesë në Gjykatën Themelore Prishtinë-dega në Lipjan çdo person i cili është Pronar ose Zotërues i Ineresit në pronën ose të drejtat pronësore të prekura nga Vendimi Përfundimtar, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në vendim, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit në përputhje me nenet 36 dhe 37 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin Nr.03/L-205 datë.28 Tetor 2010 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.91).

V. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit-Sektorit Pronësoro-Juridik, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Drejtorati për Infrastrukturë.

VI. Ky vendim paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtorati për gjeodezi dhe Kadastër është i obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.

VII. Vendimi Përfundimtar hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe publikimit të tij në njëri nga gazetat me tirazh më të madh në Kosovë.

Vendimi i'u dërgohet:

- Novica Jorgiq (Stojadin),
- Milena Laziq (Stojadin) dhe
- Zorica Daniqiq (Stojadin)
- Drejtorati për Urbanizëm Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Drejtorati për Buxhet dhe Financa
- Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër
- Drejtorati për Infrastrukturë
- Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim
- Arkivit të Komunës

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

PRESDENNIK OPŠTINE

IBr.464/01-57437
Datum:22.06.2023

Na osnovi stavova člana 11,13 Zakona o Lokalnoj Samoupravi br.03/L-040, Službene Novine Republike Kosova, Br. 28 dt 4 Juni 2008, člana 4 i člana 11 zakona Br.03/L-139 za eksproprijaciju nepokretne imovine, Službene Novine Republike Kosova, Br.52/08 Maj 2009 sa promenama i dopunama obavljene sa Zakonom Br.03/1-205, Službene Novine Republike Kosova, Br. Nr.91/10 Decembar 2010, stavova člana 83 Zakona za Opštu Administrativno Proceduri Br.05/L-031 Službene Novine Republike Kosova, Br.20/21 Juni 2016, član 40 i 41 Statuta Opštine Lipljan 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Predsednik Opštine Lipljan donosi:

ZAVRŠNU ODLUKU

I. USVAJA SE eksproprijacija nepokretne imovine, za ostvarivanje cilje i pravne javne koristi za izgradnju segmenata puta „Bashkim Krasniqi“ u Lipljanu, katastarske jedinice P-71409044-01879-1 površine 201m² u s. Katastarska zona Lipljan na ime Novica Jorgiq (Stojadin), Milena Laziq (Stojadin), Zorica Daniqiq (Stojadin) iz Lipjana.

II. De ove Odluke akat procenjivanja u kojem je određen iznos kompenziranja za one vlasnike ili imalaca interesa, pravo vlasništva ili zakonskih interesa kojima je dotaknulo imanje u procesu eksproprijacije.

III. Od dana stupanja na snazi ove Odluke, obavezuje se Direktor za Budžet i Financije, da u roku od dve (2) godine isplati u celini iznos kompezacije ekspropriisane imanje određene prema izveštaju procenjivanja Kancelarije Procenjivanja Nepokretne Imanja u okviru Ministarstva Financije- Departament za Poreza na Imovino Republike Kosova dt.12.06.2023.

IV. Protiv ove Odluke unutar trideset (30) kalendarskih dana nakon stupanja na snazi, imaju pravo da podnesu žalbu u Osnovni Sud Priština-ogranak Lipljan svako lice je vlasnik ili vlasnik interesa ili pravo vlasništvo dodatnute, kao svako zainteresiovano lice ima neki direktan materialni interes u nepokretnu imovinu, nezavisno ako nije identifikovan ili ne u Odluci ,za protivljenju iznos kompenzacije u skaldu sa članom 36 i 37 Zakona Br.03/L-139 za Eksproprijaciju Nepokretne Imovine sa dopunama i promenama Zakona Br.03/1-205 dt.28 Oktobar 2010 (Službene Novine Republike Kosova Br.91).

